



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:057717
Datë: 17.12.2024
Numri i dokumentit: 06611277

C-III-17-0233

Paditësi: S A nga fshati L, Komuna e Prizrenit

Kundër palës së paditur:

KBI “Progres” (Lavërtari Blegtori)- Prizren e cila administrohet nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, rruga Dritan Hoxha nr.55, Prishtinë, e përfaqësuar nga V H.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Kolegji në përbërje nga gjyqtari kryesues Asllan Krasniqi dhe gjyqtarët anëtarë; Manushe Karaqi dhe Sylejman Shumolli , pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike të datës 05.12.2024,ndërsa me datën;17.12.2024,merr këtë:

A K T G J Y K I M P Ë R S H K A K T Ë M O S P A R A Q I T J E S

Hedhet poshtë kërkesëpadia e paditësit S A nga fshati L, Komuna e Prizrenit e parashtruar kundër të paditurës KBI “Progres” (Lavërtari Blegtori)- Prizren e cila administrohet nga Agjencia Kosovare e Privatizimit me të cilën ka kërkuar të anulohet kontrata e shitblerjes së paluajtshmërive e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Prizren me numër Leg.nr... te vitit .. e lidhur në mes të K/N A dhe palës së paditur,me të cilën ka kërkuar që të vërtetohet se paditësi është trashëgimtar dhe pronar i paluajtshmërive të cilat evidentohen si ngastra kadastrale me numër.. në vendin e quajtur G P J, me kulturë arë në sipërfaqe prej 7348 m2, numër. . në vendin e quajtur B t, me kulturë arë në sipërfaqe prej 10458 m2, numër.. në vendin e quajtur R b-p me kulturë arë, në sipërfaqe prej 5923 m2 të cilat evidentohen sipas fletës poseduese nr., ZK L Prizren, dhe paluajtshmëria me numër.. në vendin e quajtur Sh i p, me kulturë arë në sipërfaqe prej 3117 m2 e cila evidentohet sipas fletës poseduese nr.. ZK T dhe pala e paditur të obligohet të pranoj që paluajtshmëria në fjalë t’i dorëzohet në posedim dhe shfrytëzim të lirë në afatin prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nuk caktohen taksa gjyqësore.

Reathanat faktike dhe procedurale

Paditësi S A kanë parashtruar padi kundër të paditurës KBI “Progres Export” (Lavërtari Blegtori)- Prizren e cila administrohet nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, përmes të cilës i kanë propozuar gjykatës që pas shqyrtimit të provave të lëndës kërkesëpadinë e tij ta miratoj në tërësi si të bazuar. Gjykata ka ftuar me ftesa të rregullta palët ndërgjyqëse për të prezantuar në seancën e datës;05.12.2024, edhe përkundër faktit se ftesën për prezantim në seancë e ka afishuar në tabelën e shpalljeve së gjykatës, pasi që paditësi sipas shpërndasit të postës thuhet që është i panjohur në këtë adresë ashtu si është shënuar edhe në padi dhe i njëjti nuk ka njohtuar gjykatën për ndërrimin e adresës ashtu që pala paditëse nuk ka prezantuar në seancën e lartë cekur.

I autorizuari e palës së paditur në seancën e datës 05.12.2024 pas njoftimit nga gjykata pala paditëse nuk prezanton i ka propozuar gjykatës që të merr Aktgjykim për shkak të mosparaqitjes konform nenit 58 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit nr.06/L-086.

Gjykata ka aprovuar propozimin e palës së paditur bazuar në dispozitën e nenit 58 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës nr.06/L-086 duke vendosur ashtu si është përcaktuar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Shpenzimet e procedurës;

Në bazë të nenit 62 paragrafi 5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës,secila palë do ti heqë shpenzimet e veta.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet kërkesë me shkrim në afatin kohor prej 30 ditëve për prishjen e këtij aktgjykimi Gjykatës së shkallës së parë e cila e ka marrë këtë aktgjykim, ndërsa nëse kjo gjykatë e refuzon kërkesën e palës paditëse me aktvendim, atëherë i njëjti mund t'i drejtohet me ankesë Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, brenda afatit prej 15 ditësh, llogaritur nga data e pranimit të këtij aktvendimi.

Asllan Krasniqi, Gjyqtar kryesues

Manushe Karaqi, Gjyqtare anëtare dhe

Sylejman Shumolli, Gjyqtar anëtar